

## URGJENCA

1. Kur një pacient bën shok anafilktik nga një medicament, cili do të jetë aksioni i parë që ndërmerr infermieri.
  - a) Adrenalinë s/c 1/3 e ampoules
  - b) Prednizolon 25 mg me perfusion.
  - c) Duke e informuar për atë çka i ndodhi.
2. Nëse një pacient është me TA në shifrat 180-120 dhe me shtrëngime në gjoks, cila nga këto aksione është e gabuar:
  - a) Matja e temperaturës.
  - b) Realizimi i një EKG urgjent
  - c) Rregullimi i pozicionit të pacientit nga shtrirë (dorsal) në pozicionin anash (lateral).
3. Një pacient i hospitalizuar paraqet dyspne, cyanoze, frekuencë respiratore të shtuar, cili do të jetë pozicioni më i përshtatshëm që duhet rregulluar nga infermieri:
  - a) Shtrirë (dorsal).
  - b) Përmbys (ventral).
  - c) Gj/shtrirë (semi folloëer)
4. Një pacient është inkoshient, cilat nga elementët duhet të observojë infermieri:
  - a) Sa i orientuar është ai në kohë dhe në hapësirë.
  - b) A i përgjigjet ngacmimeve si psh, nga injeksionet
  - c) A di të përgjigjet pyetjeve se ku ndodhet dhe se ç' ditë është.
  - d) Të gjitha së bashku.....!
5. Një pacient me dhimbje të forta barku, bark shumë të fryrë, me të vjella me përmbajtje të fekalizuara. Çfarë duhet Infermieri të observojë me më shumë kujdes:
  - a) Ngjyrën, përbërjen e të vjellave, konsistencën, erën, sasinë.....!
  - b) Koshiencën e pacientit.
  - c) Reagimin e tij.
6. Një pacient paraqet marrje fryme, nauze, dhimbje koke dhe skuqje të fytyrës. Cilat nga aksionet që ndërmerr infermieri janë të sakta:

- a) Matja e tensionit arterial.
  - b) Vendosja e një perfuzioni të thjeshtë.
  - c) Realizimi i elektrokardiogramës.
  - d) Të treja së bashku.....!
7. Një pacient paraqet tension arterial 70-40, pulsi pothuaj i paprekshem, cilat nga aksionet duhet të ndërmarre më me urgjencë infermieri.
- a) Aplikimin e një ampule adrenaline i/venoz
  - b) Vendosjen e kateterit urinar.
  - c) Salacio.
8. Gjatë mjekimit të një plage kirurgjikale me intervent kirurgjikal para tre ditësh , çfarë është më e rëndësishme që infermieri duhet të përshkruajë në dosjen e kujdesjeve .
- a) Ngjyrën e lekurës rreth plagës
  - b) Temperaturën e pacientit.
  - c) Tensionin arterial.
9. Pacienti paraqet melena që prej dy ditësh dhe ai duhet të porositet të ushqehet me “
- a) Dietë të zakonshme.
  - b) Muhalebi
  - c) Fruta te fresketa.
10. Pacienti që prej tre ditësh është i hospitalizuar me melena. Infermieri duhet me domosdoshmëri të observojë:
- a) Tensionin arterial.
  - b) Bilancin biokimik dhe atë klinik.
  - c) Pulsin.
  - d) Të gjitha së bashku
11. Pacienti manifeston gjëndje gjumi, djersë profuse, hypoglicemi. Infermieri ndërhyt menjëherë me :
- a) Perfuzione me pika të shpejta.
  - b) Sol glukoze 40% i/venozë
  - c) Të pijë sa më shumë lëngje .

12. Pacienti vjen në urgjencë me djegie me gëlqere në syrin e djathtë: infermieri menjëherë:

- a) Fillon perfusion me pika të shpejta
- b) Lavazh të syrit me një legen me ujë të vakët
- c) Fashimin e syrit .

13. Pacienti vjen në urgjencë me epistaxis prej dy orësh infermieri menjëherë duhet të :

- a) Mat tensionin arterial ë cili rezulton i lartë.
- b) Vendos tampon për ndalimin e hemoragjisë.
- c) Aplikon diuretikë sipas porosisë së mjekut.
- d) Të treja së bashku.

14. Pacienti prej më shumë se 18 orë nuk ka urinuar, ka fryrje barku, edemë të ekstremiteteve të poshtme, marrje fryme, infermieri duhet urgjent të:

- a) Vendosi kateterin urinar dhe aplikon diuretikë sipas porosisë së mjekut
- b) Aplikon perfuzione me pika të shpejta.
- c) Aplikon medikamente analgjezike.

15. Pacienti prej dy ditësh është me diarre, temperature, të vjella. Infermieri menjëherë ndërmerr aksionet e tij, cila nga këto nuk është e nevojshme:

- a) Dërgon një koprokulturë në laborator.
- b) Dërgon një bilanc hidrik në laborator.
- c) Dërgon pacientin për një echografi kardiake
- d) Fillon aplikimin me perfusione me ringer sipas porosisë së mjekut.

16. Pacienti prej dy ditësh është me diarre, temperature, të vjella. Infermieri menjëherë ndërmerr aksionet e tij, cila nga këto është e gabuar:

- a) Aplikimi me antipyretik .
- b) Sol primperan i/venoze.
- c) Sol ringer 500ml.
- d) Sol furosemid 40 mg, 2ml, 2ampula i/venoze,

17. Pacienti menjëherë paraqet kolika renale, të vjella, nervoz. Infermieri ndërmerr këto aksione, po cila nga këto nuk është e nevojshme:

- a) Dërgon në laborator një urinë komplet.

- b) Dërgon pacientin për një echo renale.
- c) Aplikon një ampulë buscopan i/m dhe papaverinë i/m.
- d) Realizon një elektrokardiogramë urgjente

18. Pacienti paraqet menjëherë dhimbje të forta koke, skuqje në fytyrë, marrje mendsh. Infermieri menjëherë duhet të:

- a) Bën një ro.grafi të kokës.
- a) Bën matjen e temperaturës.
- b) Bën një matje tensioni dhe të pulsit urgjent.

19. Pacienti ka aritmi të shtuar, cila nga veprimet që ndërmerr infermieri është e panevojshme:

- a) Mat tensionin arterial dhe pulsën.
- b) Realizon elektrokardiogramën .
- c) Aplikon medikament betablokues p/os ose i/venoze.
- d) Aplikon katerin urinar

20. Një pacient sapo ka pësuar një aksident në këmbë dhe ka hemoragji në vendin e plagës, infermieri menjëherë duhet të ndërmarre aksionet, cila nga këto aksione është e panevojshme.

- a) Pastron plagën nga papastërtitë dhe komprimon në vendin e hemoragjisë.
- b) Dërgon pacientin për ro.grafi të këmbës.
- c) Vlerëson parametrat jetësorë.
- d) Dërgon pacientin për rezonacë të këmbës.

21. Gjatë një ataku asthmic tek një pacient, infermieri gjatë terapisë çfarë duhet të aplikojë së pari :

- a) Eupfillinën 2.4% me 20 ml nacl i/venoze shumë ngadalë.
- b) Prednizolonin 25 mg me 500ml nacl i/venoz
- c) Të dyja bashkë një flakon nacl 500ml.

22. Pacienti me kater urinar prej 7 ditësh ka dhimbje në fundin e barkut ,djegje gjatë urinimit. Infermieri nuk duhet të :

- a) Aplikojë lavazh me sol fiziologjik.
- b) Aplikojë fryrje- shfryrje të ballonit të katerit.

c) Heq menjëherë pa bërë asnjë veprim.

23. Në hypotension cili është pozicioni ë pacientit.

- a) Përmbys.( ventral)
- b) Koka poshtë këmbët lart.
- c) Anash.

24. Në temperaturë të lartë cili është veprimi që ndërmerr infermieri duke aplikuar:

- a) Mediëament antipiretik.
- b) Diuretic
- c) Bronchodilatator.

25. Në temperaturë të ulët cili është veprimi që ndërmerr infermieri duke aplikuar::

- a) Medikament antipyretiv
- b) Të ngrohta.
- c) Perfuzion me glukozë
- d) Kompresa të ftohta.

26. Në një arrest kardiak ne c'raport e realizojmë një masazh kardiak :

- a) Me 5 masazhe 1 frymëmarrje artificiale.
- b) Me 10 me 1.
- c) Me 10 me 2

27. Në hiperglicemi cili është veprimi që ndërmerr infermieri duke aplikuar:

- a) Insulinë
- b) Glukozë 5%
- c) Glukozë 40%